



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 janar 2015
Nr.ref.:RK751/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI129/14

Parashtrues

Faik Azemi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 270/2013,
të 4 shkurtit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Faik Azemi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 270/2013, të 4 shkurtit 2014. Vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë *“shkelur e drejta e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI129/14 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI129/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 16 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij që të dorëzojë dëshmi për datën e dorëzimit të vendimit të kontestuar. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 25 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet shtesë në Gjykatë.
9. Më 7 tetor 2014, Gjykatës Themelore në Prishtinë i është kërkuar të dorëzojë dëshmi lidhur me datën e dorëzimit të vendimit të kontestuar te parashtruesi i kërkesës.
10. Më 10 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dëshmitë e kërkuara.
11. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 29 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C1. nr. 515/2007) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, se marrëdhënia e

tij e punës i ishte ndërprerë në mënyrë të paligjshme, dhe urdhëroi Komunën e Prishtinës që t'ia pranojë parashtruesit të kërkesës të gjitha të drejtat që i kishte pasur për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007, si sekretar i Shkollës së mesme të bujqësisë "Avdyl Frashëri" në Prishtinë.

13. Më 23 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1816/2009) obligoi Komunën e Prishtinës që t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës pagat e papaguara, për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007, duke përfshirë edhe kamatën.
14. Më 25 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë refuzoi si të papranueshme ankesën e paraqitur nga Komuna e Prishtinës, për shkak të mospagesës së taksave gjyqësore.
15. Më 12 gusht 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës (Aktvendimi CA. nr. 3581/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së paditur, Komunës së Prishtinës, dhe vërtetoi Aktvendimin (C. nr. 1816/09) e Gjykatës Komunale në Prishtinë.
16. Më 9 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 1220/2013) lejoi përmbarimin e aktvendimit. Komuna e Prishtinës parashtrroi një kundërshtim kundër aktvendimit për përmbarim. Gjykata Themelore e refuzoi kundërshtimin si të pabazuar.
17. Në një datë të pacaktuar, Komuna e Prishtinës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilin kontestoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (CA. nr. 3581/2012 të 12 gushtit 2013).
18. Më 4 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi nr. 270/2013) pranoi revizionin e paraqitur nga Komuna e Prishtinës, anuloi vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe e ktheu rastin për rigjykim.
19. Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi:

“Nga shkresat e lëndës del se e paditura taksat gjyqësore për ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, C. nr. 1816/2009 datë 23.11.2011 e ka paguar me datën 04.06.2012, çka vërtetohet edhe nga urdhërpagesa me nr. fiskal 600365226. Këtë urdhërpagesë gjykata e shkallës së dytë ka pasur në shkresat e lëndës. Vërejtja për pagesë të taksës gjyqësore të paditurës nga ana e Gjykatës Komunale, Prishtinë i është dorëzuar me 02.05.2012, të cilës e paditura ka pranuar me 04.05.2012, ndërsa vërejtjen e fundit e paditura ka pranuar me 01.06.2012. Në bazë të nenit 3.2 pika (c) të Udhëzimit administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore nr. 2008/02, është përcaktuar se parashtruesit të parashtrësve duhet të i caktojë datën deri kur ai duhet të paguajë taksën. Sipas vërejtjes së fundit për pagimin e taksës për të paditurën, afati ka qenë 7 ditë. Duke u nisur nga fakti se e paditura vërejtjen e fundit ka pranuar më 01.06.2012, dhe se urdhëri për obligim pagesës në emër të taksave për ankesë nga ana e paditurës në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është bërë me 06.06.2012, nënkupton se bartja e mjeteve në emër të taksës gjyqësore është bërë në afat ligjor.

Gjykata e Apelit në këtë çështje juridike duhet të vlerësojë të gjitha pretendimet ankimore të paditurës dhe pastaj të merr vendim meritor lidhur me ankesën e të paditurës”.

20. Më 8 prill 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin Ac. nr. 3779/13 e refuzoi ankesën e debitorit, Komunës së Prishtinës, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 1220/13, të 12 nëntorit 2013.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“... Ky Aktvendim shkel Kushtetutën, Nenin 31 të Kushtetutës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkel edhe nenet 6.5, 6.6, dhe 6.7 të Udhëzimit Administrativ 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore”.*
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“... Është shkelur edhe e drejta për një proces të rregullt. Këso shkelje bën Gjykata Supreme sepse përkundër faktit se të dy gjykatat (Gj. Themelore dhe Gj. e Apelit) kanë hudhur poshtë ankesën e të paditurës si të palejuar për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore”.*
23. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe ta detyrojë Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës ta përmbarojë Aktvendimin nr. 3581/2012, si dhe urdhrin për përmbarim E. nr. 1220/2013, të 30 prillit 2014.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

27. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

...

c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”.

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, i cili i ishte dorëzuar atij më 20 mars 2014. Afati prej 4 (katër) muajve ka kaluar më 20 korrik 2014. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 13 gusht 2014.
29. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është dorëzuar pas afatit prej 4 (katër) muajsh, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.
30. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit i është dhënë mundësia për të shpjeguar se pse kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit të paraparë me ligj. Përkundër kërkesës në Gjykatë, ai nuk ka dhënë asnjë shpjegim.
31. Rrjedhimisht, kërkesa është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014 njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani